

Nr. 51/12 0008-21 . Prot

Tiranë më 17.05 2021

**URDHËR  
"PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"**

**Drejtuar:** Qendra Kombëtare e Biznesit

**Adresa:** Tiranë

**Per dijëni: Debitorit :** Shoqeria "ALBRECOVERY" shpk

Nipt L82418029E

**Adresa:** territori i Uzines ferrokromit, Paper, Elbasan

**Kreditor :** Shoqeria "International Security Albania" shpk

Nipt L02004016V

**Adresa:** Tirane

Pranë Zyra e Përmbarrimit Privat "BESA"sh.p.k, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarrimore me numër 0008-21 regj dhe me palë:

Kreditor : Shoqeria "International Security Albania" shpk Nipt L02004016V

Debitorit : Shoqeria "ALBRECOVERY" shpk Nipt L82418029E

Objekti : Likujdim Fature

**KONSTATOVA:**

Për titullin ekzekutiv "Fatura Tatimore nr.80 dt.31.07.2020; Fatura Tatimore nr.89 dt. 11.08.2020" është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit "Vendimi Nr. 461 Akti datë 12/03/2021 i Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan", me palë kreditore Shoqeria "International Security Albania" shpk dhe palë debitore Shoqeria "ALBRECOVERY" shpk "

Me vendim të përmbarruesit gjyqësor privat, mbështetur dhe në nenin 519 të K. Pr. Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, rrjedhimisht për ekzekutimin e tij, duhet të kryhet verifikimi dhe vendosja masës së sekuestros në QKB, mbi aktivin që zotëron pala debitore.

Për këtë arsye në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile

**URDHËROJ :**

1. Vendosjes e masës së sekuestros konservative në aksionet, kuotat e debitorit Shoqeria "ALBRECOVERY" shpk Nipt L82418029E , me si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimin e këtyre aksioneve/kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë.
2. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në të tjera aksione/kuota të cilat zotërohen nga pala debitore Shoqeria "ALBRECOVERY" shpk Nipt L82418029E në shoqëritë e tjera të regjistruara pranë regjistrit tregtar.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenet 606 e vijues të K. Pr. Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
5. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor te vendit te ekzekutimit brenda 5 ditëve nga marrja dijëni.

Zyra e Përmbarrimit Privat "BESA"sh.p.k  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
Jonida PROGA

